



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

Nr. Prot. 685 Vlorë, 11.03. 2026



ZYRA VENDORE E ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR VLORË

Nr. Prot. 641/Vlorë, 24.03. 2026

MARREVESHJE BASHKEPUNIMI

NDERMJET:

UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORË

DHE

ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR VLORË-HIMARË

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, përfaqësuar nga **Rektore Prof. Dr. Aurela Saliq**, është një institucion publik, që ka statusin juridik, krijuar në pajtim me nenin 57, paragrafi 7 i Kushtetutës së Shqipërisë dhe të ligjit 80/2015 «Për arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë»,

dhe

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Vlorë-Himarë, përfaqësuar **nga zj. Gentiola Shehu, Drejtor** institucion publik, që ka statusin juridik krijuar në pajtim me nenin 57 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe të ligjit Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë".

Nisur nga interesi i përbashkët për zhvillimin e praktikave mësimore, duke vlerësuar kontributin e deritanishëm si dhe me dëshirën e mirë për të konsoliduar bashkëpunimin tonë palët bien dakort të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi (më poshtë "**Marrëveshja**")



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Neni 1

Qëllimi i marrëveshjes

Kjo marrëveshje ka për qëllim, bashkëpunimin ndërmjet Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë dhe Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Vlorë-Himarë në kuadër të zhvillimit të praktikës mësimore nga ana studentëve të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, për plotësimin e studimeve universitare të tyre në nivelin "Bachelor" apo "Master", pranë shkollave në varësi të ZVAP Vlorë-Himarë.

Neni 2

Baza ligjore

Zhvillimi i praktikës mësimore bazohet në ligjin 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, ligjin Nr.69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligji Nr.10 171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë" ...dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Urdhërit Nr.31, datë 28.01.2020 "Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë", VKM – së Nr.77, datë 28.01.2015 "Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor".

Neni 3

Fusha e zbatimit

Kjo marrëveshje bashkëpunimi, zbatohet midis Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë dhe Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Vlorë-Himarë për zhvillimin e praktikës mësimore për programet mësimore "Bachelor" apo "Master".

Studentët e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, do ta zhvillojnë praktikën mësimore pranë shkollave në varësi të ZVAP Vlorë-Himarë, sipas listës që do të përcillen nga Njësitë kryesore të Universitetit pranë ZVAP.

Neni 4

Detyrimet e palëve

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Vlorë-Himarë , merr përsipër:

1. Lejimin e studentëve të UV-së, për të zhvilluar praktikën mësimore pranë shkollave të caktuara nga Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Vlorë-Himarë.
2. Udhëzimin e drejtuesëve dhe mësuesve të institucioneve arsimore parauniversitare publike në lidhje me zhvillimin e praktikës mësimore të studentëve pranë këtyre shkollave.
3. Në bashkëpunim me drejtuesit e shkollave, caktimin e një apo më shumë mësuesve (në varësi të numrit të studentëve) për orientimin, mbikqyrjen, mentorimin e studentëve gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të praktikës mësimore.



4. Në bashkëpunim me drejtuesit e shkollave, raportimin pranë Universitetit të Vlorës mbi problematikat e ndryshme që mund të jenë krijuar nga ana e studentëve të hasura gjatë periudhës së zhvillimit të praktikës mësimore, pranë institucioneve arsimore të ndryshme.

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, merr përsipër:

1. Depozitim, (para fillimit të praktikës mësimore), pranë çdo drejtorie të shkollave të përcaktuara nga ZAVP, listës emërore (me firmë dhe vulë nga Njësia bazë) të studentëve që do të zhvillojnë praktikën mësimore.
2. Depozitim pranë Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Vlorë-Himarë të dokumentit justifikues ligjor në lidhje me derdhjen e kontributeve për aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale të të gjithë studentëve që do të zhvillojnë praktikën mësimore për të gjithë periudhën e praktikës mësimore, në zbatim të VKM – së Nr.77, datë 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”.
3. Orientimin e studentëve në lidhje me respektimin e rregullores së shkollës, orarin e përcaktuar nga drejtuesit e shkollës, etj, me qëllim mos cënimin dhe mosprishjen e orës mësimore në këto institucione arsimore parauniversitare ku studentët janë caktuar për të kryer praktikën mësimore.

Palët kanë detyrimin të mbrojnë të dhënat personale që përpunohen dhe në mënyrë të veçantë për të dhënat sensitive, në përputhje me ligjin Nr. 9887, datë 10.3.2008, i ndryshuar “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Neni 6

Respektimi i marrëveshjes

Institucionet bien dakord që, nëse për arsye grevash, ose mosmarrëveshesh të punës, motit të keq, “Fuqisë Madhore” ose shkaqeve të tjera objektive të cilat janë të pashmangshme, shkaktuar përtej mundësisë që kanë ato për t’i kontrolluar, në mbështetje të këtij paragrafi, nëse institucionet nuk janë të afta të kryejnë detyrimet e tyre, kjo pamundësi e tyre nuk do të konsiderohet si prishje e Marrëveshjes.

Neni 7

Mirëbesimi

1. Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë dhe Zyrën Arsimore Vlorë-Himarë do të respektojnë parimin e mirëbesimit të ndërsjelltë.
2. Palët duhet të rruajnë dhe të administrojnë me mirëbesim të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të shkëmbyera prej tyre në lidhje me këtë Marrëveshje.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Neni 8
Afati i marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje do të lidhet për një kohëzgjatje 5(pesë) vjeçare nga data e nënshkrimit
2. Pas përfundimit të datës së përcaktuar në paragrafin e mësipërm, kjo marrëveshje mund të zgjatet bazuar në një marrëveshje të përbashkët me shkrim.
3. Marrëveshja mund të zgjidhet nga secila Palë, nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim Palës tjetër, të paktën 6 (gjashtë) muaj përpara.

Neni 9
Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj.
2. Kjo marrëveshje është hartuar në 3(tre) kopje origjinale në gjuhën Shqipe, nga 1(një) kopje do të depozitohen në Rektoratin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë dhe Njësinë Kryesore, 1(një) kopje do të depozitohet në Zyrën Arsimore Vlorë-Himarë.

PËR

UNIVERSITETIN
"ISMAIL QEMALI" VLORE

REKTORE

PROF. DR. AURELA SALIAJ

A Saliaj

PËR

ZYRA VENDORE E ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR VLORE-HIMARË

DREJTORE

GENTIOLA SHEHU

G. Shehu



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

SHPËRNDARJA E STUDENTËVE SIPAS SHKOLLAVE PËR PRAKTIKËN PROFESIONALE
NË PROGRAMIN MP PËR CLAB, NË GJUHË ANGLEZE. VITI AKADEMIK 2025-2026

(ZVAP VLORE)

Kodi	Lënda	Institucioni i praktikës (VLORE)	Emri i Studentit
ENG 490	Prakt. prof.	Shkolla 9- vjeçare " Muço Delo" (Vlorë)	Elmira Memushaj
ENG 490	Prakt. prof.	Shkoll 9 vjeçare " Avni Rustemi" (Vlorë)	1. Alda Dalipaj /2.Samra Omerbasic
ENG 490	Prakt.prof.	Shkolla 9 vjeçare " Rilindja" (Vlorë)	Enxhi Zanaj
ENG 490	Prakt.prof.	Shkolla e muzikës "Naim Frashëri" Vlorë	Jonalba Rakipi
ENG 490	Prakt.prof.	Shkolla e Bashkuar " Hysen Çino" Horë, Vranisht, Vlorë	Flavia Qejvanaj

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Përgjegjëse e Departamentit të Gjuhëve të Huaja
Prof As.Dr. Kozeta Hyso